



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.122/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Kimete Kicaj dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Lutfie M. Ajvazi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik koalicionit AAK-PSD, me seli në Prishtinë, dega në Deçan, për shkak të vendosjes së posterit në hapësirë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019 në seancën e panelit të mbajtur me datë 30.09.2019, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) me seli në Prishtinë, ndërsa subjekti politik koalicionit AAK-PSP, me seli në Prishtinë, dega në Deçan, i shqiptohet dënim me gjobë në vlerë prej 2,100 (dymijë e njëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë), ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 28.09.2019, nga Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme në vend ka vërejtur një parregullsi të cilën e ka evidentuar me fotografi të printuara. Paraqitësi i ankesës potencon se me datën 28.09.2019, monitoruesi i tyre ka hasur në poster të kandidatëve për deputet nga Koalicioni AAK-PSD, të vendosur në hapësirë publike. Me këtë rast paraqitësi i ankesës thekson se nga Koalicioni AAK-PSD, është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b) i LZP-së Ligji Nr.03/L-073 dhe konsideron se Koalicioni AAK-PSD, ka shkel këtë nen në momentin që ka vendosur poster të kandidatëve për deputet të tyre në hapësira publik. Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e Kodit të Mirësjelljes.

Në përgjigjën në ankesë, nga subjekti politik koalicioni AAK-PSD, të datës 30.09.2019, kanë theksuar se vendosja e posterit nuk është vendosur nga strukturat e partive në koalicion AAK-PSD, dhe se këtë poster duhet ta kenë vendosur përkrahësit e kandidatëve në fjalë. Pavarsishtë kësaj subjekti politik koalicioni AAK-PSD, njofton se ka ndërrmar masat e duhura dhe ka evituar shkelën e pretenduar duke larguar foton e kandidatëve për deputet nga ky koalicion menjëherë pas pranimit të ankesës, pra nga këto veprime është evitar shkelja sipas pretendimeve në ankesë. Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkangjitur një fotografi nga vendi ku është larguar posterit i kandidatëve për deputet nga koalicioni AAK-PSD, lidhur me rastin në fjalë si dhe disa fotografi nga publikimi në media të thirrjes në emër të koalicionit AAK-PSD, për respektimin rigoroz të rregullave zgjedhore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidatëve për deputet nga koalicioni AAK-PSD, dega në Deçan, është vendosur në hapësirë publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton

*“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike”*

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik koalicionit AAK-PSD, është shkelur nen 33 pika b) i LZP-së, nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, pasi që posteri i kandidatëve për deputet nga koalicioni AAK-PSD, është vendosur në hapësira publike. Të cilën shkelje nuk e ka pranuar subjekti politik koalicioni AAK-PSD, në përgjigjen në ankesë të datës 30.09.2019.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik koalicioni AAK-PSD, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrrethanë, PZAP-i mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për t'u përgjigjur, ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre, nuk e kanë pranuar shkeljen e supozuar, me arsyetimin se posteri nuk është vendosur nga strukturat e partive në koalicion AAK-PSD, dhe se këtë poster duhet ta kenë vendosur përkrahësit e kandidatëve në fjalë. Brenda afatit të caktuar nga PZAP-i, subjekti politik ka ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes, i cili veprim ka ndikuar në shqiptimin e gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, sepse sipas nenit 3 par. 1 te Rregullores së PZAP-it Nr. 01/2012, shkeljet e kësaj natyre të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mund ti shqiptohet gjobë subjektit politik nga 5,100.00 euro deri në 10,000.00 euro, mirëpo siç u konstatua me lart, veprimet e subjektit politik, për ta përmirësuar shkeljen, ka ndikuar në shqiptimin e gjobës.

Subjekti politik brenda afatit të caktuar ka ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Me këtë vendim dhe shqiptim të gjobës paneli vendosi se do të ndikon te subjekti politik që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen. Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr. 122/2019 më datën 30.09.2019



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së